



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 28/2015

Prishtinë, më 28.07.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Besim Beqaj, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë;

Pjesëmarrës të tjerë: Remzije Hajdari dhe Veli Hoti-MTI; Dukagjin Shala- MZHE; Lumnije Murati dhe Erblina Morina- ZPRK; Izet Shehu, ekspert; Kaltrina Ahmeti dhe Tringa Bytyçi-GLPS; Visar Berisha dhe Dardan Abazi - INDEP; Arta Krasniqi - OSBE; Fjolla Uka -KDI; Sylejman Blaku-Kosova-Sot; Ismail Shabani- Kosova Press; Albulena Mavraj –Epoka e Re; Avni Uka -Bota Sot; Besa Berisha (praktikante UNDP).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.7.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës;
4. Shqyrtimi i nismës legjislative “Projektligji për siguri në punë në miniera”;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.7.2015;

Procesverbali nga mbledhja e datës 21.7.2015 u miratuan me plotësime nga deputeti Raif Qela, i cili do të deponojë më shkrim tek stafi i Komisionit.

3. Shqyrtimi ne parim i Projektligjit nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar z.Avni Kastrati, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe propozoi që së pari të paraqes arsyetimin e Projektligjit nr.05/L-051 për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës dhe pastaj të hapim debatin.

Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekti legjislativ, shkurtimisht paraqiti qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligji për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës. Ai tha se arsyeshmëria për këtë projektligj është krijimi i një sistemi të mirëfilltë të mbrojtjes së drejtave në fushën e Pronësisë Industriale që është një prioritet i përcaktimeve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht Qeverisë së Republikës së Kosovës. Po ashtu arsye tjetër është harmonizimi i këtij projektligji me Acquis-in e BE-së, ku edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën 2014 është shtruar nevoja për përafrimin e mëtutjeshëm të Ligjit për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës me Legjislacionin e BE-së. Ai tha se ky projektligj hap rrugë për transpozimin e Rregulloreve dhe Direktivave Evropiane të pronësisë industriale, të cilat do të mundësojnë qasje më të lehtë në mbrojtjen e pronës industriale në Kosovë. Ky Projektligj përcakton rregullat për mënyrën e fitimit dhe mbrojtjes së emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë të produkteve si dhe përcaktohen të drejtat dhe procedurat e regjistrimit të emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë të produkteve. Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet për të cilat mbrojtja e emërtimeve të origjinës ka origjinë nga një rajon, vend specifik ose shtet. Për herët të parë me këtë ligj do të mbrohet po ashtu edhe specialitetet tradicionale të garantuara, të cilat mbrohen në BE-së konform Rregulloreve relevante. Z. Kastrati, tha se Projektligji është harmonizuar me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), konkretisht neni 118 i TFBE-së, dhe me rregulloret e veçanta të cilat janë paraqitur në tabelat e përputhshmërisë së këtij drafti. Ai në fund paraqiti objektivet që parashihen pas miratimit të Ligjit për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës sigurohet një mbrojtje më e mirë e produkteve, bujqësore dhe jobujqësore, kosovare të cilat mund të mbrohen me tregues gjeografikë apo emërtime të origjinës. Siç mund të jeni të informuar, Kosova ka disa lloje të verërave të cilat vijnë nga regjione të ndryshme gjeografike të Kosovës dhe konsideroj që këto verëra mund të mbrohet me tregues gjeografikë. Për më tepër, kemi dhe regjione të njohura për prodhimin e produkteve bujqësore si psh. Regjioni i Sharrit, ku mund të mbrojmë disa produkte, sikur “Djathi i Sharrit” me emërtim të origjinës. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij Ligji në fushën e pronësisë industriale ju propozoj që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë Projektligj, tha në fund zëvendësministri Kastrati.

Kryetari i Komisionit, kërkoi sqarim pse projektligji për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës në memorandumun shpjegues është si plotësim- ndryshim, ndërsa në projektligji ka ardhur si i ri?

Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, sqaroi së projektligji është proceduar nga MTI-ja si projektligji i ri, sepse më nismën procedurës për plotësim- ndryshim është dashur të ndryshohen shumë nene, andaj, është konsideruar me lehtë të hartohet si projektligji i ri.

Visar Ymeri, pyeti së me projektligjin për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës se a do të mbrohen produktet e vendeve gjeografike brenda Kosovës? Çfarë efekti ekonomik ka pas ky ligj i deritanishëm? Çka e bënë këtë ligj më të zbatueshëm sesa ai që është në fuqi? Dhe, tani pas aprovimit të projektligjit, cilat produkte vendore do ti mbrojnë?

Kryetari i Komisionit, pyeti cilat do të jenë efekte ekonomike në zbatim të projektligji Dhe më aprovimin e ligjit a po ndërtohen kapacitetet për t'i mbrojtur produktet e origjinës vendore?

Veli Hoti, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, tha që ligji i deritanishëm nuk ka qenë në harmoni me Direktivat e BE-së, prandaj ka filluar nisma për hartimin e projektligji për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës. Ai theksoi së më anë të këtij projektligji parashihet mbrojtja e gjitha produkteve vendore, si p.sh. prodhuesve të verërave që të janë 8 (tetë) në Kosovë, po ashtu edhe “djathit të Sharrit”, cilat këto produkte deri më tani nuk janë mbrojtur nga Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës. Efekti ekonomik do të jetë i madh sepse prodhuesi kosovar do të jetë i mbrojtur e jo i diskriminuar nga importi.

Pal Lekaj tha së moszbatimi i ligjit në fuqi nga ana e MTI-së, ka ardhur si rezultatit që BE-ja t'iu rekomandojë fillimin hartimit të ri projektligjit për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës. Ai shtoi së po kemi një mosgatishmëri të institucioneve përgjegjëse për moszbatim të ligjeve në përgjithësi. Andaj kemi disa produkte si shuma verërave dhe ujit që prodhohen në Kosovë, që deri më tani nuk janë mbrojtur nga shteti.

Raif Qela tha që më aprovimin e projektligjit për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës do të mbrohen produktet e kësaj fushë, po ashtu do të mundësohet edhe mbrojtja e konsumatorëve më anë të deklarimit të përmbajtës së origjinës. Ai theksoi së në parim është për miratimin Projektligjit për Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës dhe gjatë dy leximeve mund të japë sugjerim për përmirësimet e mundshme.

Blerim Grainca propozoi që të bëhet një listë e produkteve brenda Projektligjit për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, në mënyrë që më lehtë t'i mbrojmë prodhimet vendore nga vendi origjinës. Po ashtu edhe për produktet importuara në Kosovë të kemi deklarimet e vendit gjeografik të origjinës së nga vjen produkti, në mënyrë që zbatimi i ligjit në praktikë të jetë më letë.

Kryetari i Komisionit tha se duhet të konstatojmë që po dalin kërkesa që për ligjin: për markat tregtare, patenta dhe për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës që janë të ndërlidhur njëri më tjetrin si pako e ligjeve. Të organizohen fushata të vetëdijesimit, kjo të bëhet së bashku më asociacionet e bizneseve që për këto tri ligje të cekura që të jenë një pako në mënyrë që investorët të mos kenë hezitim për të filluar më investime. Ai shtoi së gjatë shqyrtimit në mes të dy leximeve, do të shohim mundësitë e thjeshtëzimit të procedurave për mbrojtjen e origjinës së produkteve në mënyrë që të MTI-ja të bëjë një listë së cilat produkte do t'i mbrojmë më Ligjin për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Visar Ymeri tha që roli i MTI-së është që t'i organizojë prodhuesit vendorë dhe që të ketë një regjistër së në cilat rajone ka prodhues dhe cilat janë produktet e tyre që i prodhojnë, pastaj MTI-ja dhe institucionet tjera si zbatues të ligjit të kenë më të lehtë që t'i mbrojnë prodhimet nga vendi i origjinës, kur të regjistrohen së nga vjen prodhim dhe produkti final, atëherë do të duhet të

ruhet edhe cilësia e prodhimit dhe të mbrohet marka brenda vendit të origjinës dhe sipas Direktivave të BE-së.

Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, tha që janë duke u bërë hapat e parë që të krijohen kushtet për eksportin e prodhimeve vendore dhe në bazë të ligjit do të kenë shenjën gjeografike të origjinës së prodhimit të mallit.

Enver Hoti lidhur për cilësinë prodhimeve të mallit që vjen nga origjina, tha që të bëhen edhe specifikacionet e produktit në bazë të ligjit për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Duda Balje lidhur për prodhimin e “djathit të Sharrit”, tha se me sa ka informacione, nuk kanë laboratorë për kontrollimin e cilësisë dhe pyeti se a ka planifikuar MTI-ja që për Projektligjin për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, të caktohet së cila është përbërja e mallit të prodhuar? Ajo theksoi se investitorët duhet të investojnë në ngritjen e kapaciteteve, që të vlerësojnë cilësinë e produkteve.

Avni Kastrati, zëvendësministër, sqaroi se sa i përket kontrollit të përbërjes dhe cilësisë se mallit të prodhuar në Kosovë, kemi laboratorin në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, për çdo produkt, qoftë i prodhuar brenda Kosovës apo që importohet në Kosovë.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, propozoi që të aprovohet në parim Projektligji nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës dhe të formohet grupi i punës, i cili do të analizojë dhe do amendamentojë Projektligjin në fjalë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë :

R e k o m a n d i m

1. Miratohet në parim projektligji nr.05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës;

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij Projektligji, pas miratimit të parim nga Kuvendi, do të jetë në këtë përbërje: Pal Leka , kryesues, Sala Berisha- Shala dhe Duda Balje, anëtarë.

4. Shqyrtimi i nismës legislative “Projektligji për siguri në punë në miniera;

Kryetari Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit, lidhur me këtë pikë dhe tha se grupi i caktuar i punës ka hartuar draftin e nismës legislative për “Projektligjin për siguri në punë në miniera”. Ai falënderoi për punën që e bërë dhe pastaj fjalën ia kaloi fjalën znj. Sala Berisha-Shala, kryesuese e grupit të punës.

Sala Berisha- Shala, në cilësinë e kryesueses së grupit të punës paraqiti arsyeshmërinë e nismës legislative për “Projektligjin për siguri në punë në miniera”. Së pari tha, falënderoj anëtarët e Komisionit, të cilët e përkrahen që sot të vijmë deri të ky moment, ndërsa se dyti falënderoj kolegët e grupit të punës, z.Raif Qela dhe z.Enver Hoti. Falënderim i posaçëm shkon për ekspertin e angazhuar, profesorin Izet Shehu, pa punën e të cilit, ne sot nuk do ta kishin këtë draft. Po ashtu e falënderoj edhe Institutin INDEP z.Dardan Abazi, që na ka mbështet në të gjitha aktivitetet si dhe stafin mbështetës së Komisionit për punën e tij në shërbim të grupit të punës dhe Komisionit. Ajo e njoftoi Komisionin se grupi i punës ka bashkëpunuar ngushtë edhe me

institucionet si Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, KPMM-në, Inspektoratin e Punës si dhe institucionet tjera relevante. Qëllimi i nismës legislative është mbrojtja në punë nënkupton përcaktimin e rregullave, kushteve dhe formave të veprimit në zvogëlimin dhe largimin e shkaktarëve të lëndimeve të punëtorëve në punë, por edhe në menaxhimin e të gjitha segmenteve që vështirësojnë dhe pengojnë punën në të gjitha fazat e procesit teknologjik të punës sepse në këtë mënyrë i kontribuohet edhe realizimit të efekteve teknike dhe ekonomike në ngritjen e produktivitetit të punës në minierat e Kosovës. Me rritjen e mjeteve dhe pajisjeve të punës gjithnjë e më shumë ndërlikohen edhe proceset punuese, të cilat kërkojnë një përkushtim më të madh ndaj rreziqeve të dala nga to, si qasje e vetë kryerësve të punëve për mbrojtjen e vetvetes, qoftë edhe si shprehje e interesit të punëdhënësit për mbarëvajtje dhe mënjanim të faktorëve që ndikojnë negativisht në proceset prodhuese. Ky ligj ka për qëllim të mbështes në masë të plotë, legjislacionin në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë në miniera, ngritjen e vetëdijes në këtë fushë, dhe krijimin e një kulture të punës dhe krijimin e parakushteve për mirëqenien në punë dhe cilësinë e jetës dhe shëndetit në punë. Përmes këtij Ligji mbrojtja në punë do të përfshin masat dhe mjetet për krijimin e kushteve të sigurta të punës që realizohen me largimin e shkaqeve të lëndimeve, sëmundjeve, invaliditetit dhe rasteve vdekjeprurëse në procesin e punës. Znj. Berisha e prezantoi bazën juridike e cila rregullon mbrojtjen në punë në Republikën e Kosovës, që siç tha ajo janë: është Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligji për minierat dhe mineralet 2010, i ndryshuar në vitin 2013; Rregullore për Sigurinë minerare, 2011; Ligji i Punës, dhjetor 2010; Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, 2013; Aktet ndërkombëtare të punës - Karta sociale evropiane 1966 me protokollet e saj; Ligje tjera (Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Ligji për mbrojtjen nga rrezatimi, etj); Marrëveshja e përgjithshme kolektive, e aprovuar në 2014, implementimi në vitin 2015. Pastaj paraqiti aktivitetet e grupit të punës si vijon: 1.4.2015 – Komisioni mori vendim për të mbështetur nismën e propozuar; 1.4.2015 – Formohet Grupi i punës: Sala Berisha – Shala kryesuese, Raif Qela dhe Enver Hoti anëtarë; 29.4.2015 – Grupi i punës mbajti mbledhje; 19.5.2015 –Komisioni vendosi që të angazhojë si ekspert z. Izet Shehu; 3.6.2015 – Grupit të punës ia prezantoi eksperti, koncept- dokumentin për nismën legislative; 30.6.2015 – Eksperti dorëzoi ekspertizën sipas kërkesës; 6.7.2015 – Grupi i punës organizoi punëtori, ku pjesëmarrës ishin të gjitha palët e interesit; 15.7.2015 – Grupi i punës mbajti mbledhje; 22.7.2015 – Grupi i punës mbajti mbledhje ku është përcaktuar për draftin përfundimtar. Ajo paraqiti përmbajtjen e Ligjit për Siguri në Miniera nen për nen, në mënyrë telegrafike, si në vijim: Neni 1, Qëllimi i ligjit; Neni 2, Fushëveprimtaria; Neni 3, Përkufizimet; Neni 4, Masat teknike dhe të mbrojtjes në punë gjatë punimeve minerare; Neni 5, Shërbimi i kërimit-shpëtimit, zjarfikësve dhe shërbimi i ndihmës së parë; Neni 6, Veprimet në rastin e shfaqjes së rreziqeve të papritura; Neni 7, Punëtorët me autorizime dhe përgjegjësi të posaçme, në kryerjen e punëve teknike profesionale, në fushën e mbrojtjes në punë dhe shëndetit të punëtorëve; Neni 8, Detyrimet për marrjen e masave; Neni 9, Njohja me rregulloret; Neni 10, E drejta në informim në rast të ndërrimit të vendit të punës; Neni 11, Organet përgjegjëse për inspektim; Neni 12, Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Minerave; Neni 13, E drejta për ankesë; Neni 14, Gjybat; Neni 15, Nxjerrja e akteve nënligjore dhe Neni 16, Hyrja në fuqi. Znj. Berisha- Shala, paraqiti procedurën e mëtutjeshme, duke theksuar si në vijim: pas miratimit të sotëm ky draft do të procedohet tek dy drejtori këtu në Kuvend, tek Drejtoria për Harmonizimin me Legjislacionin e BE-së, ku do të marrim një opinion se a është kjo nisme në harmoni me legjislacionin e BE-së; si dhe Drejtoria për Buxhet, ku do të marrim po ashtu opinion se miratimi i kësaj nisme apo ligji paraqet implikime buxhetore për shtetin. Ndërkohë, derisa të kemi opinionin e këtyre dy drejtorive, stafi i Komisionit do ta hartojë Memorandumin shpjegues. Pasi t'i marrim opinionet nga këto dy drejtori dhe Memorandumin shpjegues nga stafi i Komisionit, kryetari i Komisionit më një shkresë përcjellëse kërkon nga Kryesia e Kuvendit që nismën legislative ta procedojë të Qeveria, e cila do të ketë një muaj afat për të kthyer përgjigje. Pas kësaj, pas kalimit të afatit njëmuajor, nisma i shpërndahet deputetëve më Vendim të Kryesisë së Kuvendit dhe merr statusin e Projektligjit për siguri në punë në miniera dhe, futet në procedurë të rregullt sikurse çdo projektligj tjetër. Në fund, ajo tha se

miratimi i kësaj nisme legislative është e një rëndësie të veçantë sepse qëllimi i këtij ligji është që të vendosë standarde minimale për sigurinë në punë në aktivitetet minerare dhe të përcaktojë kërkesat bazë të sigurisë në punë për poseduesit e licencave dhe lejeve minerare dhe ftoi për përkrahje .

Kryetari kërkoi sqarim, sa i përket Inspektoratit në miniera, që është i rregulluar më Ligjin për miniera dhe minerale dhe kërkoi të sqarime për rolin e tij në këtë ligj.

Izet Shehu, ekspert që ka punuar në “Projektligjin për siguri në punë në miniera”, tha që për këtë ligj ka pas nevojë, sepse çështja e sigurisë në punë në miniera është rregulluar vetëm në nenin 75 të Ligjit për miniera dhe minerale, prandaj si i tillë nuk garanton siguri të mjaftueshme për siguri në punë në miniera. Shehu theksoi së ekziston Rregullorja për siguri në punë në miniera e hartuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, por siç dihet nuk e ka fuqinë e plotë sikur ligji. Prandaj, është parë nevoja e rëndësishme dhe domosdoshme e hartimit të Projektligjit për siguri në punë në miniera. Ai tha gjatë shqyrtimit pikë për pikë e nen për nen, kemi ardhur në përfundim së është i nevojshëm projektligji për siguri në punë në miniera. Z. Shehu, ceku se problemin dhe një çështje që ka mbetur e hapur në Projektligjin për siguri në punë në miniera, është se a duhet të mbikëqyrë punën në miniera, Inspektorati i Minierave i KPMM-së apo Inspektorati i Punës që është në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ndërsa, tha që Projektligji për siguri në punë në miniera, lidhur më Direktivat e BE-së është përshtatur, dhe se nuk ka implikime buxhetore.

Visar Ymeri pyeti se kujt i përgjigjet Inspektorati i Minierave, që është në kuadër të KPMM-së? Për gjrobat, sa mendoni së Inspektorati i Minierave mund ta kryej këtë punë? Ai tha se në nenin 14, te gjrobat për secilin rast ka gjobë, por nëse ekziston ndonjë fatalitet gjatë orarit të punës në miniera, gjoba nuk mjafton dhe për këtë nen propozoi që të ceket që duhet t'i referohemi Kodit Penal të Kosovës. Mandej, te neni 12, në paragrafin 5, ku për rastet e fatkeqësive, aksidenteve apo lëndimeve të rënda në punë ta pezullojë aktivitetin minerar, aty ku ka ndodhur lëndimi apo prishja, dhe të lajmërohet inspektori më së largu brenda 12 (dymbëdhjetë) orëve për ditë të punës dhe 24 (njëzetekatër) orë për ditë vikendi apo festave shtetërore, duhet të ndryshohet dhe të zvogëlohet dhe të veprojë më shpejt. Po ashtu tha, Ymeri, te ky nen, në paragrafin 7, Inspektorati i Minierave është i detyruar të kryejë vizitën inspektuese të punimeve minerare dhe objekteve më së paku 1 (njëherë) në vit, ndërsa objektet minerare të rrezikuara nga metani dhe pluhuri i rrezikshëm i qymyrit, me së paku 1 (njëherë) në 6 (gjashtë) muaj. Duhet të ndryshohet, në rastin e parë të jetë 2 herë në vit ndërsa në rastin e dytë çdo tre muaj.

Kryetari pyeti çka është më specifike që e rregullon këtë Projektligj? Sepse nuk e kemi ende arsyeshmërinë e qartë. Grupi i punës a është konsultuar më krejt palët, por edhe inxhinierët e KEK-ut dhe të minierave tjera si “TREPÇA” etj? Kërkoj që më anë të këtij ligji duhet të rregullohet preventiva që mund të parandalohen fatkeqësitë gjatë orarit të punës nëpër miniera. Ai paraqiti vërejtje konkrete të neni 4, i cili duhet të sqarohet, po ashtu u pajtua me deputetin Ymeri që ato afate të neni 12 të ndryshohen si dhe me nenin 15, te nxjerrja e akteve nënligjore duhet të rishikohen se a ka nevojë për të gjitha këto akte të nxirren.

Sala Berisha- Shala dha disa sqarime duke thënë se Projektligji për siguri në punë miniera, tani është vetëm një draft dhe ka mjaft hapësirë për përmirësim kur të procedohet në Kuvend në mes të dy leximeve. Sa i përket pyetjes së a është konsultuar grupi i punës më inxhinieret e KEK-ut dhe minierave, tha që grupi i punës ka organizuar një punëtori ku kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e KEK-ut; MZHE-së; MPMS-së dhe KPMM-së.

Izet Shehu tha që Rregullorja për siguri në miniera është mirë që është futur një pjesë e saj në ligj, pasi që nuk ishte fuqia e kësaj rregulloreje sesa ligji, edhe në Ligjin për miniera dhe minerale janë ruajtur të gjitha dispozitat që janë në fuqi. Sa i përket gjobave, tha se qëllimi i gjobave më tepër ka të bëjë më disiplinimin e kompanive dhe punëdhënësit.

Enver Hoti tha se i gjithë aktiviteti i grupit punues është harmonizuar më gjitha palët që kanë të bëjnë më këtë sektor. Sa i përket preventivës tha, që këto janë rregulluar më nenin 5 të projektligjit që ka të bëjë shërbimi i kërkimit –shpëtimit, zjarrfikësve dhe shërbimi i ndihmës së parë, prandaj për të gjitha këto çështje kemi pasur një bashkëpunim dhe konsultim më gjithë aktorët që mbulojnë këtë fushë.

Pal Lekaj për nenin 5 të projektligjit që ka të bëjë më shërbimin e kërkimit dhe shpëtimit, zjarrfikësve dhe shërbimi i ndihmës së parë, propozoi që të shtohet edhe vizita sistematike çdo 6 muaj e mjekëve, po ashtu kërkoi që të behët edhe kategorizimi i lëndimeve të lehta dhe të rënda.

Fatmir Rexhepi tha se pasi që grupi i punës e ka hartuar draftin për Projektligjin për siguri në punë në miniera dhe e ka përfunduar punën e vet, tani i mbetet komisionit ta rregullojë fazën e dytë e pastaj ta dërgojë në Qeveri.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Konkluzion

- 1. Të hartohet memorandum shpjegues i Projektligjit për siguri në punë në miniera;*
- 2. Të rregullohet teksti i Projektligjit për siguri në punë në miniera më gjitha propozimet dhe vërejtjet e Komisionit.*

5. Te ndryshme

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e komisionit se deputeti Raifi Qela ka një propozim amendament lidhur me Projektligjin për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive dhe tokësore, pastaj ia kaloi fjalën për të paraqitur amendamentin.

Raif Qela tha më gjithë vullnetin e mirë që ka pasur Grupi punues dhe Komisioni për ta përgatitur një projektligj sa më të mirë për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore, këtë synim nuk e kemi arritur. Disa çështje që kanë të bëjnë me këtë proces nuk i kemi adresuar fare, ose i kemi adresuar gabimisht. Prej tyre, njëra që sipas vlerësimit tim e ka peshën më të madhe, e pa rregullimin e së cilës nuk mund të ketë fare proces të digjitalizimit, është mungesa e zgjidhjes së problemit të multipleksëve rajonalë. Të gjitha të tjerat edhe mund të kapërdihen disi, por ky është i patejkalueshëm. Sponsor i këtij projektligji, Qeveria, në projektligjin që na e ka ofruar, e ka përcaktuar se nga dy ofrues rajonalë të shërbimeve mediale do të rehatohen në multipleksët qendrorë. Kjo zgjidhje u pa se nuk është e qëndrueshme, sepse është e pamundshme të realizohet teknikisht. Kjo për arsye se nuk ka mundësi që nga multipleksët qendrorë, sinjali të përçohet vetëm në një rajon, pa e çuar dëm atë brez frekuence. Do të thotë kjo zgjidhje nuk është kurrfarë zgjidhje, ngase planifikimi i rrjetit duhet të bëhet në atë mënyrë që të shfrytëzohet në mënyrë sa më racionale brezi i frekuencave. Grupi punues e ka identifikuar këtë problem dhe parimisht është pajtuar që t'i japë zgjidhje përmes modelit të dhënies me koncesion të multipleksëve rajonalë dhe të rrjeteve rajonale, dhe atë me automatizëm, pa procedurë tenderi. Kjo për arsye se nga të qenit operator i multipleksit rajonal, përfitimet janë tepër të papërfillshme dhe askush nuk do të rrezikojë që të investojë aty ku nuk i ka të sigurta përfitimet.

Qeveria nuk ka mjete që t'ua bëjë rrjetin. Rrjedhimisht, zgjidhja më fatlume është ajo e propozuar më lart. Kjo zgjidhje ka qenë e propozuar edhe nga KPM-ja dhe është miratuar në të gjitha fazat edhe nga AMPEK-u. Dhe jam i sigurt se për këtë do ta kemi edhe mbështetjen e sponsorit, do të thotë, Qeverisë. Për t'u siguruar se do ta kemi edhe mbështetjen e nevojshme nga palët e interesuara, sot bisedova në telefon me ekspertin e Qeverisë, z. Agim Kukaj, edhe me përfaqësuesin e AMPEK-ut, z. Visar Hoti. Që të dy u pajtuan se ky propozim është zgjidhja më e mirë për këtë problem. Edhe po të ecë plotësisht mirë procesi i tenderimit të multipleksëve qendrorë, edhe po të vihen në funksion multipleksët e rrjetat qendrore, pa zgjidhjen e problemit të ofruesve rajonalë e lokalë të shërbimeve mediale nuk ka digjitalizim. Ky proces do të dështojë. Nëse deri sa të zgjidhet kjo çështje vazhdojnë transmetimet analoge krahas atyre digjitale, të gjithë do të kenë shpenzime marramendëse shtesë për shkak të stërzgjatjes së procesit. Por ka shumë gjasa që të ketë interferenca të mëdha, për shkak se është pothuajse e pamundshme të bashkëveprojnë njëkohësisht pa pengesa të mëdha të dy llojet e transmetimeve. Pa plotësim me amendament të këtij problemi, jam plotësisht i bindur se ky proces do të dështojë. Dhe propozimi im është që ne si Komision t'ia shtojmë amendamentit ekzistues 17, tekstin e propozuar prej meje edhe në mbledhjen e kaluar:

Amendamenti 17 Neni 13 ndryshohet si në vijim:

2. Ofruesit rajonalë e lokalë të shërbimeve mediale bëhen me automatizëm operatorë të multipleksit dhe rrjetit përkatës rajonal, në bazë të rregullave dhe kushteve që do t'ua caktojë KPM-ja.

Këtë plotësim t'ia propozojmë seancës së Kuvendit, pa e çuar përsëri nëpër komisione, me po të njëjtën procedurë, siç bëri Komisioni për Buxhet e Financa në seancën e fundit të Kuvendit. Edhe përkrahjen e qeverisë do ta kemi. Ky plotësim është minimumi i domosdoshëm që ky projektligj të bëhet funksional, tha Qela .

Fatmir Rexhepi e përkrahi propozimin e deputetit Qela dhe kërkoi që kryetari i Komisionit të propozojë në seancë këtë ndryshim.

Kryetari tha se duhet të takohemi edhe me institucionet si MZHE, KPM, ARKEP dhe palët e interesit dhe t'ia propozojmë këtë ndryshim dhe mandej të vendosim.

Komisioni e autorizoi kryetarin e komisionit z.Muhamet Mustafa dhe kryesuesin e Grupit të punës z.Raif Qela, që të takohen më përfaqësues të MZHE-së, KPM-së, ARKEP-së dhe AMPEK-së për t'ia propozuar këtë amendament dhe mandej ta njoftojnë Komisionin dhe seancën e Kuvendit, për këtë plotësim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa